



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:190830  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739733

**PA1.nr.1401/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësorë Visar Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.H, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.H av. G.H, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2936/19, i datës 18.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të A.H, av. G.H, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 2936/19, i datës 20.09.2023, Vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.2936/19, i datës 18.09.2023, të akuzuarit A.H, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim, në shumë prej katërqind (400) euro, të cilën dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë gjykata konform nenit

46 par.3 të KPRK-së, do ta zëvendësojë me dënim me burg, ku një ditë me burg do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës. Konfiskohet arma revole e tipit ZORAKI M2906 1(një) karikator si dhe një fishem konform nenit 366 par.3 të KPPRK-së. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzime procedurale dhe në emër te paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej njëzet (20) eurove, në emër të kompensimit të viktimave të krimit obligohet të paguajë shumën prej tridhjetë (30) eurove, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H, av. G.H, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal-lartësinë e dënimit me propozim që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën e mbrojtësit si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më ulët me gjobë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1435/2023 të datës 09.11.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H, me av. G.H, e ankimon aktgjykimin për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe lidhur me lartësinë e dënimit me pretendimin me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit A.H ka shqiptuar një dënim shumë të lartë dhe një dënim i tillë do te ja vështirësonte jetën jashtëzakonisht, kjo sepse i njëjti ka të hyra pothuajse minimale dhe edhe aktualisht me shumë vështirësi ia del për të mbijetuar vet dhe për të mbajtur familjen. Gjykata në shqiptimin e dënimit, ka shqiptuar një dënim i cili përkon me praktikën gjyqësorë, por nuk përkon me rrethanat personale të të mbrojturit tim. nuk përkon me gjendjen ekonomike dhe sociale te tij. Të nderuar, i akuzuari që nga fillimi i procedurës ndaj tij është treguar bashkëpunues dhe qysh në fillim të procedurës ka pranuar veprat penale të cilat i bijën në barrë, kjo për faktin që i njëjti menjëherë pas kryerjes së veprës penale e ka kuptuar gabimin të cilin e ka bërë dhe ka reflektuar menjëherë, kjo vërtetohet edhe me pendimin e tij të sinqertë në seancën gjyqësore. I akuzuari asnjëherë nuk ka qenë i dënuar më herët dhe është hera e para qe ka renë ndesh me ligin dhe kjo ka ndodhur pakujdesia e jo

me paramendim apo qëllim. Nisur nga kjo rrethanë personale të të mbrojturit tim konsiderojmë që dënimet e shqiptuara janë të larta si dënimi me gjobë dhe po ashtu konsiderojmë se gjykata nuk ka marrë parasysh disa rrethana ne matje të dënimit e që në këtë rast janë: Moshë e tij e re, pendesa e tij e singertë, kërkim falje e tij e singertë po ashtu, kujdesi i tij për familjen. baba i pesë fëmijëve, bashkëpunimi i tij me organet e rendit dhe të drejtësisë. Qëllimi i dënimit konsiderojmë se nuk është hakmarrja që të bëhet ndaj kryesit të veprës,, por rehabilitimi i tij që në të ardhmen te mos kryej vepra tjera penale e në këtë rast konsiderojmë se ky qëllim veç është arrit për arsyeje se i mbrojturi im qe nga dita kritike e incidentit asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin e po ashtu ka kuptuar rëndësinë e dënimit. Siç edhe dihet sipas nenit 38 të KPRK-së, qëllimi i dënimit është që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen rehabilitimin e tij e nuk është hakmarrja ndaji tij për veprën e kryer, konsiderojmë që ky qëllim është arritur qysh në fillimit të procedurës sepse i akuzuari ka shfaqur pendesë, andaj një dënim kaq. i lartë nga gjykata më shumë tingëllon si dënim hakmarrës se sa dënim rehabilitues dhe në lartësinë e tillë është i nevojshëm. Duke qenë një situatë të tillë konsiderojmë që lartësia dënimit të shqiptuar me gjobë është shumë e madhe dhe nuk përkon as me praktikën gjyqësore dhe pikërisht këtë kërkojmë që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i ulët me gjobë dhe po ashtu kërkojmë që të i ulët dënimi me burg. Andaj, duke pasur parasysh praktikën gjyqësore situatën ekonomike të të akuzuarit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të bazuara. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, premtimin para gjykatës se nuk do t'i përsëris veprimet e ngjashme, andaj të pandehurit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të aktgjykimi. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret korospodon me gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Një vlerësim të këtyllë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më i butë. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e

përgjegjesisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjesisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.1401/23, më datë 23.05.2024**

**Procesmbajtësi,**  
Visar Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Mehmet Ndrecaj

---

Ferit Osmani

---